URDHËR
Nr. 90, datë 28.4.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa "a", të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Kombëtar të Punësimit për dërgimin me shërbim të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km.
2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar.
3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj